

# DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



## TAKIM ME “SEKTORIN E TURIZMIT”

Turizmi është një nga sektorët kryesorë në vend, që mundëson rritje ekonomike me efekt të lartë tek shumë aktorë të tregut dhe gjeneron sasi të konsiderueshme të të ardhurave në buxhetin e shtetit, buxhetin sipërmarrës dhe atë familjar. Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare zhvilloi “Takimi me Sektorin Turizmit”, si pjesë e bashkëpunimit dhe nxitjes së oportuniteteve për biznesin vendas dhe partneritet me Diasporën. Takimi u realizua pranë zyrave të Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, Sky Tower, në një fashë orar të hapur, në respekt të protokolleve **COVID-19**, ku morën pjesë përfaqësues të ndryshëm nga sektori i turizmit në vend. Gjatë takimit me përfaqësues të sektorit u diskutua mbi potencialin e mëtejshëm të turizmit, zonat e interesit, kapacitetet, kushtet e sigurisë etj.

PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU: >>>>



## PATENTIMI I PRODUKTEVE “MADE IN ALBANIA” MUNDËSI PËR KONKURRIM NË TREGJE E MËDHA

Mbrojtja dhe patentimi i produkteve “Made in Albania” ka një rëndësi të madhe, pasi jo vetëm mbrojmë traditën, por iu jep mundësi sipërmarrjeve të rrisin cilësinë dhe të konkurrojnë denjësisht në tregje më të mëdha. Në konferencën e zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale “Mbrojtja e të drejtave të pronësisë industriale, hap i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit”, ministrja e Financave dhe Ekonomisë, theksoi rëndësinë që ka regjistrimi i markës dhe patentës. Regjistrimi i markës siguron lehtësi jo vetëm në tregun shqiptar, por edhe atë të huaj.

PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU: >>>>



## EKSPORTI I KËPUCËVE DHE TEKSTILEVE TË SHQIPËRISË JEP SINJALE POZITIV NË GUSHT!

Eksporti i tekstileve dhe këpucëve, që përbën një zë të rëndësishëm të tregtisë së jashtme të Shqipërisë, ka shfaqur shenja rikuperimi gjatë muajit gusht. Referuar të dhënave të publikuara nga INSTAT, Shqipëria eksportoi këtë gusht 7.5 miliardë lekë nga ky grup mallrash, duke njohur një rritje me 1 miliardë lekë krahasuar me gushtin e vitit të kaluar.

PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU: >>>>



## JAVA NË LAJME :

GJERMANI/ BESNIK KELMENDI: DO PËRFAQËSOJ  
ZËRIN E SHQIPTARËVE NË KOMUNËN ESSEN



KOSOVA “SHPËTON” TURIZMIN E SHQIPËRISË,  
NË GUSHT PUSHUESIT PËRBËN 62% TË HYRJEVE



FRANCË/EMIGROI NË MOSHËN 17-VJEÇARE,  
SOT PRONAR I KOMPANISË SË PARË QË E PUNËSOI



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	105. <sup>70</sup>	106. <sup>60</sup>
EUR	123. <sup>50</sup>	124
CHF	113. <sup>90</sup>	115
GBP	134. <sup>40</sup>	135. <sup>70</sup>
DKK	16. <sup>27</sup>	16. <sup>67</sup>